



Data: 22.02.2019

Ref.: 344/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit Universi (Nr.1463/18H, datë 31.10.2018) për akreditim të programit të studimit si më poshtë:
 - Infermieri, MSc, 120 ECTS, dhe

- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji Universi ka parashtruar kërkesë (Nr.1463/18H, datë 31.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditim të programeve të studimit si në vijim: Infermieri, MSc, 120 ECTS, dhe Kulturë Fizike, Sport dhe Rekreacion, MSc, 120 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KSHC në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e Kolegjit Universi, dhe pas analizës së dokumentacionit të stafit akademik bazuar në pikën 1.2 të nenit 10 të UA për Akreditim, sipas së cilit: *“Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”,* erdhi në përfundim se programi i studimit: Infermieri, MSc, 120 ECTS, nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim të aplikacionit.

Bazuar në nenin e referuar më sipër KSHC ka verifikuar te gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit. Këto te dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KSHC-së të mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019, dhe pas shqyrtimit të dosjes për secilin staf akademik, KSHC mori vendim që të refuzojë aprovimin e aplikacioneve të Kolegjit Universi, sipas pikës një të dispozitivit të këtij vendimi.

- Për programin e studimit: *Infermieri, MSc, 120 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji Universi ka paraparë dy persona: Kadir Hyseini, dhe Ragip Ratkoceri.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Ky program ka 120 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Universi, duhet të ketë të paktën dy anëtarë të stafit akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.


Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji Universi për këtë program të studimit, u konstatua që asnjëri nga dy bartësit e prezantuar si bartës të programit *Infermieri MSc*, nuk i përkasin fushës së studimit të këtij programi. Kadir Hyseini është PhD në Lëndët Paraklinike, ndërsa Ragip Ratkoceri është PhD në Lëndët Klinike.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, dhe në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Infermieri, MSc, 120 ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi u dërgohet:

- BPrAL Kolegji “Universi”;
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë